



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 73 Prot.

Tiranë, më 17.1.2025

URDHËR

Nr. 16, datë 17.1.2025

***“PËR FILLIMIN E MBIKËQYRJES SË ORIENTUAR MBI ZBATIMIN E LIGJIT NË
ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL, NË KONKURRIMET E PLANIFIKUARA
PËR T’U ZHVILLUAR NGA DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
GJATË VITIT 2025, ME PROCEDURAT E PRANIMIT NË NIVELIN EKZEKUTIV
NË SHËRBIMIN CIVIL, LËVIZJES PARALELE, NGRITJES NË DETYRË DHE
PRANIMIT NË TRUPËN E NËPUNËSVE CIVILË TË NIVELIT TË LARTË
DREJTUES (TND)”***

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Vendimin nr. 82, datë 20.12.2024, “Për miratimin e planit vjetor të punës të institucionit për vitin 2025”, ka miratuar planifikimin vjetor të procesit të mbikëqyrjes, duke përcaktuar llojin dhe objektin e mbikëqyrjeve dhe subjektet që do të kontrollohen gjatë këtij viti.

Në këtë planifikim, duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që kanë procedurat e rekrutimit në lidhje me: **a)** pranimin në nivelin ekzekutiv në shërbimin civil; **b)** lëvizjen paralele; **c)** ngritjen në detyrë dhe **ç)** pranimin në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), në institucionet e administratës shtetërore, për të siguruar një shërbim civil të qëndrueshëm, profesional dhe të bazuar në meritë, ç’ka përbën edhe qëllimin e ligjit për nëpunësin civil, është parashikuar zhvillimi i “mbikëqyrjes së orientuar”, përcaktuar në nenin 14/1, germa “c”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, me qëllim mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të disa prej procedurave të konkurrimeve të planifikuara për t’u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2025.

Për këtë arsye,

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11/1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, e ndryshuar, si dhe në zbatim të Vendimit nr. 82, datë 20.12.2024, “Për miratimin e planit vjetor të punës të institucionit për vitin 2025”, të Komisionerit, me qëllim që të mbikëqyr zbatimin e ligjit në administrimin e procedurave të konkurrimeve të planifikuara për t’u zhvilluar, nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2025,

URDHËROJ:

1. Fillimin e mbikëqyrjes së orientuar, me objekt mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procedurave të konkurrimeve të planifikuara për t’u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2025.

2. Ngritjen e grupit të mbikëqyrjes, me këtë përbërje:

- | | |
|-----------------------------|---|
| 1. Luiseda Zhapa | Drejtore e Inspektimit dhe
Hetimit Administrativ |
| 2. Antea Kabali | Inspektore
(Anëtar) |
| 3. Françeska Doksani | Inspektore
(Anëtar) |
| 4. Ina Skënderi | Specialiste IT
(Anëtar) |

3. Metodologjia që do të ndiqet për realizimin e mbikëqyrjes së orientuar:

- Përfshin mbledhjen e të dhënave nga grupi i punës, i cili do të marrë pjesë në fazën e testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë, në disa prej procedurave të konkurrimit të përzgjedhura, për të gjitha nivelet e nëpunësisë;
- Për dokumentimin e procesit të mbikëqyrjes do të kqyren të gjitha aktet e publikuara gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit të përzgjedhura, duke i pasqyruar të dhënat e nxjerra nga këto akte, në formë tabelare (excel) me qëllim përpunimin e tyre;
- Me përzgjedhje, grupi i punës i ngarkuar me këtë proces, do të ndjekë disa nga procedurat e konkurrimit, duke e evidentuar këtë proces përmes kopjeve të akteve të hartuara gjatë zhvillimit të fazave të procedurës së konkurrimit, si dhe procesverbalin e kqyrjes të mbajtur nga grupi i punës për këtë qëllim.

4. Me përfundimin e afatit të mbikëqyrjes, do të përgatitet relacioni dhe raporti përkatës, ku do të pasqyrohet informacioni i administruar dhe propozimet përkatëse për mënyrën e ndjekjes së problemeve të evidentuara.
5. Anëtarët e grupit të mbikëqyrjes, së bashku ose veç e veç, kanë të drejtë të paraqiten dhe të kërkojnë çdo dokumentacion të nevojshëm, në të gjitha institucionet që nxjerrin akte administrative, apo kryejnë procedura të caktuara, që kanë lidhje me procesin e rekrutimit, të tilla si testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.
6. Me këtë urdhër të njihet grupi i mbikëqyrjes dhe Departamenti i Administratës Publike.
7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit për të zbatuar këtë urdhër.
8. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha